



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

RREGULLORE
Nr. 4, datë 29.03.2018

**PËR INVESTIGIMIN DHE PROCEDURAT PËR MARRJEN E MASAVE
DISIPLINORE**

Kjo rregullore është hartuar bazuar në **nenin 5, nenin 14, nenin 24, nenin 25, nenin 26, nenin 28, nenin 32, nenin 33, nenin 48, nenin 51, nenin 52, nenin 53, nenin 55, nenin 57, nenin 57/2 dhe nenin 58** të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar" të ndryshuar (në vijim ligji për auditimin).

Neni 1

Qëllimi dhe objekti i kësaj rregulloreje

1. Kjo rregullore ka për qëllim:
 - a. zbatimin e kërkesave ligjore për investigimin dhe marrjen e masave disiplinore nga ana e Bordit të Mbikëqyrjes Publike;
 - b. të vendosë rregulla dhe procedura për të garantuar të drejtat e palëve në këtë proces;
 - c. të përcaktojë përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të procesit të investigimit dhe marrjes së masave disiplinore të Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe parimet e përgjithshme për funksionimin e komisioneve të investigimit dhe disiplinës së organizatave profesionale subjekt i mbikëqyrjes së BMP-së.
2. Kjo rregullore parashikon dispozitat që rregullojnë vendosjen e masave disiplinore ndaj audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilistëve të miratuar si edhe zbatimin e tyre nga ana e BMP në përputhje me legjislacionin shqiptar.
3. Kjo rregullore gjithashtu parashikon dispozitat që rregullojnë:

- a. marrjen e masave disiplinore ndaj të gjitha subjekteve të tjera të cilat janë subjekt i drejtpërdrejt ose indirekt i mbikëqyrjes së BMP-së duke përfshirë edhe subjektet që bien ndesh dhe shkelin ligjin për auditimin (më poshtë subjekte të tjera të mbikëqyrjes);
- b. investigimin e sjelljeve të gabuara të shoqërive të auditimit, audituesve ligjorë, kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilistëve të miratuar dhe subjekteve të tjera të mbikëqyrjes mbi bazën e informacioneve të besueshme dhe kuadrit rregullator në fuqi;
- c. verifikimin e ankesave të paraqitura pranë BMP nga persona apo subjekte të tjera;
- ç. dhënia e udhëzimeve për subjektet e mbikëqyrjes lidhur me zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.

Neni 2

Përkufizimet e shkurtimeve

KIDB: Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës së BMP

KIDO: Komisionet e Investigimit dhe Disiplinës së Organizatave Profesionale të Audituesve Ligjorë dhe Organizatave Profesionale të Kontabilitetit

BMP: Bordi i Mbikqyrjes Publike

Shkelje ose sjellje të papajtueshme (të gabuara ose të këqija): Janë të gjitha ato shkelje që janë në papajtueshmëri me kuadrin rregullator në fuqi duke përfshirë legjislacionin në fuqi dhe të gjitha aktet e dala në zbatim të tij përfshirë edhe kuadrin rregullator të miratuar nga BMP. Më konkretisht në këtë kategori do të përfshihen çdonjëri nga veprimet e mëposhtme:

- Aktivitetin kriminal;
- Veprimet ose mos-veprimet që ka të ngjarë të çojnë në diskreditimin e profesionit;
- Shkeljet e standardeve profesionale;
- Shkeljet e kërkesave etike;
- Neglizhencën e madhe profesionale;
- Një numër rastesh të neglizhencës profesionale edhe pse më pak serioze, por që në mënyrë kumulative mund të tregojnë për papërshtatshmërinë e të drejtave të ushtrimit të profesionit;
- Punën e pakënaqëshme ose jo-bindëse;
- Shkelje të kërkesave të rregulloreve, rregullave, vendimeve dhe të gjitha akteve të hartuara apo të miratuara nga Bordi i Mbikqyrjes Publike;
- Shkelje të kërkesave ligjore

Subjekt i Mbikëqyrjes: Janë të gjitha ato palë të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes të Bordit të Mbikëqyrjes Publike duke përfshirë Audituesit Ligjorë, shoqëritë e auditimit, kontabilistët e

miratuar, shoqëritë e kontabilistëve të miratuar, organizatat profesionale si dhe të gjitha komisionet, komitetet dhe grupet e punës të ngritura prej ose pranë tyre, në mbështetje të ligjit për auditimin si dhe të gjithë ata individ apo subjekte që veprojnë ndesh me dispozitat e ligjit për auditimin.

Investigim bazuar në ankesë: Fillimi i një investigimi duke u bazuar në një ankesë. Ky lloj investigimi iniciohet nga BMP bazuar në një ankesë kundrejt një subjekti të mbikëqyrjes. Zakonisht këto ankesa vijnë nga një klient ose nga një agjensi tjetër rregullatore por pa u kufizuar vetëm në to.

Investigim bazuar në informacione nga burime të sigurta (të tjera): Fillimi i investigimit mbi bazën e informacionit të marrë nga burime të sigurta (kontrolli i cilësisë, palët e jashtme të cilat dokumentojnë shkeljen që raportojnë pranë BMP), që tregojnë për mundësinë e sjelljes së keqe, madje edhe po qe se nuk ka ankesë.

Investigim me kërkesë të BMP-së: (e miratuar me shumicë të thjeshtë) bazuar në një rast të justifikuar i cili ka natyrë publike ose jo.

Përpyjekjet më të mira: Një subjekt i mbikëqyrjes ka bërë përpjekjet më të mira, nëse në mënyrë të arsyeshme ai nuk mund të bënte më shumë për të përmbushur një detyrim të caktuar që vjen si rrjedhojë e kuadrit rregullator.

Verifikimi mbi bazë ankese: është procesi i njohjes dhe konfirmimit të vërtetësisë së pretendimeve apo shqetësimeve për fakte dhe rrethana që lidhen me veprimtarinë e subjekteve të mbikëqyrjes konkrete dhe që realizohet nëpërmjet marrjes, grumbullimit, analizës e ballafaqimit të të dhënave konkrete.

Komisioni Ad-Hoc: Komisioni Ad-Hoc është komisioni i investigimit dhe disiplinës së BMP-së i cili ka një mandat 1 vjeçar me përjashtim të rasteve kur dispozitat e kësaj rregulloreje parashikojnë ndryshe.

Nivelet e shkeljes: Shkeljet kategorizohen sipas koeficientëve të rëndësisë si më poshtë:

- Këshillues
- E vogël
- E mesme
- E madhe
- E konsiderueshme
- Kritike

Përcaktimi dhe përshkrimi i nivelit të shkeljeve të përcaktuara më sipër do të bëhet me vendim të veçantë të Bordit të Mbikëqyrjes Publike me analizë risku duke konsideruar faktoret e mëposhtëm:

- a. Madhësinë e aktivitetit (qarkullim/aktive) të subjektit ndaj të cilit janë ofruar shërbimet nga profesionisti kontabël (audituesit, kontabilistët e miratuar dhe shoqëritë përkatëse);
- b. Natyrën e njësisë ndaj të cilës janë kryer shërbimet (shërbimet që janë subjekt i masave disiplinore) nga profesionisti kontabël (nëse është me interes publik apo jo);
- c. Industrinë në të cilën operon njësia (Financiare dhe jo Financiare e rregulluar nga rregullatorë të tjerë ose jo);
- ç. Përsëritjen e shkeljeve;
- d. Impakti në publik;
- dh. Deklarimin vullnetar të shkeljeve.

Të gjitha termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore janë të njëjta me ato të përdorura në nenin 2 të ligjit për auditimin.

Neni 3

Organizimi dhe funksionimi i Komisionit të Investigimit dhe Disiplinës së BMP dhe bashkërendimi me komisionet homologe të organizatave profesionale të audituesve ligjorë dhe organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar

1. Me qëllim zbatimin e rregullave dhe procedurave të vendosura në këtë rregullore dhe të tjera akteve rregullore për qëllime disiplinore të vendosura në rregullore të tjera krijohet Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës pranë BMP-së.
2. BMP nëpërmjet Komisionit të Investigimit dhe Disiplinës ndërmerr vetë procesin e investigimit dhe disiplinës ndaj audituesve ligjorë / shoqërive të auditimit, kontabilistëve të miratuar, pavarësisht procedurave të ndjekura nga organizatat profesionale. Gjithashtu BMP nëpërmjet Komisionit të Investigimit dhe Disiplinës në kuadër të mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së interesit publik ndërmerr procedura investigimi dhe masa disiplinore edhe ndaj organizatave profesionale si dhe subjekteve të tjera që shkelin ligjin për auditimin apo aktet dhe ligjet e tjera në fuqi.
3. Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës ngrihet në varësi të drejtpërdrejtë të BMP.
4. KIDB përbëhet nga 3 anëtarë, Kryetari dhe dy anëtarët të cilët zgjidhen nga inspektorët e Strukturës Mbështetëse ose ekspertë të jashtëm (në përputhje me ligjin për auditimin) me vendim të BMP. Kryetari zgjidhet nga struktura mbështetëse. Në raste të veçanta të lidhura me çështje që për nga natyra kanë një kompleksitet më të madh mund të emërohen deri në 4

anëtarë të tjerë duke ruajtur një numër maksimal të KIDB prej 7 anëtarësh. Në këto raste anëtarët e rinj/ shtesë të KIDB kanë mandat të përkohëshëm i cili zgjat deri në mbylljen e gjithë procesit të investigimit dhe marrjen e masave përfundimtare disiplinore nga BMP-ja. Edhe anëtarët e tjerë zgjidhen nga radhët e inspektorëve të strukturës mbështetëse ose nga ekspertë të jashtëm (në përputhje me ligjin për auditmin dhe statutin e BMP-së).

5. Inspektorët apo ekspertët e jashtëm që do të jenë anëtarë të KIDB do të kenë një mandat 1 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje. Në rast të mbarimit të mandatit anëtarët e KIDB do qëndrojnë në detyrë deri në zgjedhjen e antarëve të rinj duke mos u kufizuar në ushtrimin e funksioneve të tyre deri në datën e zëvendësimit nga anëtarët e rinj.
6. Funkzioni i anëtarëve të KIDB të cilët vijnë nga radhët e inspektorëve përfundon kur:
 - a. Mbaron mandati dhe njëkohësisht është bërë emërimi i anëtarëve të rinj;
 - b. Kur inspektorët kanë ndërprerë plotësisht marrëdhëniet e punës ose të angazhimit me kohë të plotë pranë BMP-së, me përjashtim të rasteve kur me vendim të BMP-së emërohet si ekspert i jashtëm;
 - c. Kur gjatë periudhës së ushtrimit të mandatit bie në kushte të papajtueshmëri me kërkesat e kuadrit rregullator të miratuar nga BMP-ja. Në rastet kur papajtueshmëria është e përkohshme anëtari tërhiqet përkohësisht nga pjesëmarrja në KIDB deri në momentin e ndërprerjes së kushteve të papajtueshmërisë në përputhje me pikën 9 të këtij neni.
7. Anëtarët KIDB të cilët vijnë nga radhët e inspektorëve ose ekspertëve të jashtëm mund të emërohen dhe shkarkohen si anëtarë të këtij komisioni në përputhje me Statutin e BMP dhe rregulloren për rregullimin e strukturës mbështetëse. Rastet e shkarkimit përcaktohen në kontratën e punës/angazhimit dhe rregulloren e strukturës mbështetëse duke konsideruar së paku rastet kur veprimet apo mosveprimet e tyre:
 - a. bien ndesh me statutin;
 - b. bien ndesh me ligjin apo;
 - c. shkelje të rënda dhe të përsëritura të kësaj rregulloreje.
8. Për të shmangur konfliktin e interes anëtarët e komisionit duhet të konfirmojnë pavarësinë nga:
 - a. subjekti i kontrollit;
 - b. personat e lidhur ose të interesuar me rastin e kontrollit.
9. Në rastin e konfliktit të interes anëtarët e komisionit duhet të tërhiqen menjëherë nga rasti duke u zëvendësuar përkohësisht nga një inspektor tjetër ose ekspert i jashtëm.

10. Organizimi dhe funksionimi i Komisioneve të Investigimit dhe Disiplinës së organizatave profesionale të audituesve ligjorë dhe organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar bëhet përmes rregulloreve të hartuara nga organizatat respektive (në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj rregullore dhe kuadrin rregullator në fuqi) dhe miratohen nga BMP-ja.
11. Mënyra e organizimit të këtyre komisioneve duhet të jetë në përputhje me ligjin për auditimin dhe gjithë kuadrin rregullator të miratuar nga BMP-ja.
12. BMP mund të japë rekomandime apo sugjerime lidhur me këto rregullore të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga organizata profesionale të audituesve ligjorë dhe organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar.
13. Pagesat e anëtarëve të komisionit do të bëhen në përputhje me vendimin për referencat e honorareve për shpërblimin e anëtarëve të komisioneve të ngritura pranë BMP-së.¹

Neni 4

Pavarësia e anëtarëve të Komisionit të Investigimit dhe Disiplinës dhe Personelit të Stukturës Mbështetëse që përfshihet në procesin e investigimit

1. Inspektorët e strukturës mbështetëse apo ekspertët e jashtëm që mund të angazhohen përgjatë një procesi investigimi si pjesë e KIDB duhet të konfirmojnë që në fillim të çdo procesi investigativ se çdo anëtar i caktuar për të kryer apo ndihmuar një investigim është i pavarur nga çështja që investigohet dhe nuk është i lidhur apo ka interesa në çështjen që investigohet. Nëse ka konflikt që në fillim ose nëse konflikti lind gjatë investigimit, anëtari duhet të tërhiqet menjëherë nga investigimi i çështjes.
2. KIDB duhet të konfirmojë që në fillim të çdo procesi shqyrtimin për përcaktimin dhe propozimin e masave disiplinore se çdo anëtar i caktuar për të shqyrtuar rastin nuk është i lidhur apo ka interesa në çështjen që investigohet. Nëse ka konflikt që në fillim ose nëse konflikti lind gjatë procesit të shqyrtimit, anëtari duhet të largohet menjëherë nga procesi i vendimmarrjes së KIDB.
3. Në rast se zbulohen fakte apo rrethana që vërtetojnë konfliktin e interesit të anëtarit apo të çdo personi tjetër të përfshirë në procesin e investigimit, por që nuk janë vetëdeklaruar, atëherë Kryetari i KIDB merr masa për eliminimin e kushteve të papajtueshmërisë dhe informon BMP-në për këtë situatë.

¹ Shtuar me Vendim Nr. 65, datë 26.12.2019 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së KIDB dhe KIDO

1. Objekti i veprimtarisë së KIDB është shqyrtimi i ankesave të paraqitura nga njësitë ekonomike apo palë të tjera të përcaktuara në këtë rregullore ndaj audituesit ligjor /shoqëritë së auditimit, kontabilistët e miratuar, shoqëritë e kontabilistëve të miratuar dhe për subjektet e tjerë të mbikëqyrjes si dhe shqyrtimi i të gjitha ankesave apo informacioneve të tjera që lidhen me investigimin dhe disiplinën që vijnë pranë BMP-së.
2. Objekti i veprimtarisë së KIDB janë edhe rastet kur audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit nuk e kanë kaluar me sukses kontrollin e cilësisë për shkak të mangësive të theksuara.
3. Objekt i veprimtarisë së KIDB janë edhe të gjitha rastet e tjera të parashikuara në këtë rregullore që çojnë në nisjen e një procedure investigimi
4. Në përfundim të procesit KIDB duhet të raportojë tek BMP të gjitha gjetjet dhe rastet e shqyrtuara dhe masat e propozuara.
5. Raporti duhet të përmbajë të paktën elementët si në vijim:
 - a. Një përshkrim për aktivitetin e kryer dhe rastet e shqyrtuara gjatë periudhës raportuse;
 - b. Rastet kur është shkelur ligji, statuti i BMP-së , rregulloret, rregullat, vendimet e BMP-së dhe standardet e profesionit;
 - c. Propozimet dhe rekomandimet që prashikohen të ndërmerren në të ardhmen.
6. Komisionet e Investigimit dhe Disiplinës të ngritura pranë organizatave profesionale (të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes) kanë të drejtën të shqyrtojnë ankesat e ngritura nga palët e treta për antarët e tyre, si dhe të gjitha ankesave apo informacioneve të tjera që lidhen me investigimin dhe disiplinën që vijnë pranë tyre në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregulloret e brendshme të tyre të miratuara nga BMP-ja, pa rënë ndesh me dispozitat e kësaj rregulloreje. Në rastet kur investigimi lidhet me antarët pasivë (jo ushtrues) apo aktivë të cilët mund të jenë anëtarë të BMP-së apo kanë qenë anëtarë deri në tre vite pasi ju ka mbaruar mandati si anëtarë të BMP-së shqyrtimi i çështjes bëhet drejtpërdrejt në BMP sipas dispozitave të kësaj rregulloreje. Të njëjtat kërkesa zbatohen edhe për personat që janë angazhuar apo mund të kene qenë angazhuar si inspektorë të brendshëm apo ekspertë të jashtëm në çfarëdolloj forme, deri në tre vite pasi të kenë nderprerë marrëdhënien me BMP-në.

Neni 6

Detyrimi për dhënien e informacionit

1. Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës së BMP-së bën të gjitha hapat e nevojshëm në përputhje me këtë rregullore për të marrë evidencën e duhur dhe dokumentacionin mbështetës të lidhur me rastin.
2. Audituesit ligjorë / shoqëritë e auditimit dhe të gjitha subjektet e mbikëqyrjes të parashikuara në këtë rregullore janë të detyruar të dorëzojnë pranë Komisionit të Investigimit dhe Disiplinës së BMP-së informacionin e kërkuar.
3. Në rast se ky informacion nuk dorëzohet në kohë subjektet e mbikëqyrjes së BMP-së do të jenë objekt i masave disiplinore sipas dispozitave të kësaj rregulloreje dhe kuadrit ligjor në fuqi.

Neni 7

Raportimi i KIDB

1. KIDB harton një raport të veprimtarisë vjetore të cilën ia paraqet për miratim BMP brenda datës 15 janar të vitit pasardhës.
2. Raporti i KIDB duhet të përmbajë të paktën këto elemente:
 - a. Një përshkrim mbi aktivitetin e kryer dhe proceset investigative që janë kryer gjatë periudhës raportuese;
 - b. Shkeljet e ligjit, të akteve në zbatim të tij, të akteve statusore të BMP-së apo të rregullave dhe të standardeve të profesionit që janë konstatuar gjatë proceseve investigative;
 - c. Dobësitë dhe neglizhencat e konstatuara;
 - ç. Propozimet dhe rekomandimet për veprimet që priten të ndërmerren në të ardhmen.
3. Raporti i KIDB miratohet nga organizata profesionale respektive (në përputhje të plotë me kuadrin rregullator në fuqi) dhe kalon për dëgjimin e KIDB dhe BMP-së.
4. KIDB nëse ka sugjerime mund t'i propozojë BMP-së për t'i adresuar si rekomandime përfundimtare për rishikimin e raportit. BMP mund t'i adresojë rekomandimet edhe në mënyrë të pavarur pa qenë e nevojshme të marrë një propozim nga KIDB

Neni 8

Investigimi

1. Procesi i investigimit do të kryhet nga KIDB për të gjitha rastet e parashikuara në këtë rregullore apo në vendimet e BMP-së që dalin në zbatim të kësaj rregulloreje.
2. Investigimi kryhet në përputhje me manualin e procedurave të investigimit të miratuara me vendim të veçantë të BMP-së.
3. Në rastet kur investigimi lidhet me ndonjë nga anëtarët e organizatave profesionale (me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë rregullore) BMP-ja me propozim të KIDB mund të kërkojë nga organizatat profesionale për investigim paraprak.
4. Në mbyllje të procesit komisionet e investigimit dhe disiplinës së organizatave profesionale duhet të dorzojnë pranë KIDB, duke vënë në dijeni BMP-në lidhur me të gjitha gjetjet dhe shmangiet që kanë ndodhur duke adresuar edhe rekomandimet që lidhen me masat disiplinore. Propozimi përfundimtar bëhet nga KIDB.
5. Në rast se KIDB vë re se evidencat e grumbulluara nga komisionet e investigimit dhe disiplinës së organizatave profesionale janë të pambështetura apo të pamjaftueshme apo të pavlefshme juridikisht, atëherë KIDB ka të drejtën të mos i konsiderojë përgjatë procesit të dhënies së rekomandimit përfundimtar për BMP-në, duke u konsultuar sipas rastit, me personelin që merret me çështjet ligjore ose komisioni për çështjet ligjore sipas dispozitave të kësaj rregulloreje apo rregulloreve dhe akteve të tjera të miratuara nga BMP.
6. Rastet kur parashikohet nisja e procesit të investigimit parashikohen në nenin 10 të kësaj rregulloreje.
7. Në rastet kur investigimi do të nisë nga KIDO sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, për të garantuar objektivitetin e procesit dhe për të shmangur çdo gjykim subjektiv, anëtarët e organizatave profesionale kanë të drejtën të kërkojnë që ky investigim të kryhet nga KIDB.

Neni 9

Shkeljet që çojnë në investigim dhe marrjen e masave disiplinore

1. Në përputhje me këtë rregullore trajtohen të gjitha çështjet me shkelje ose sjellje të papajtueshme.

2. Me shkelje ose sjellje të papajtueshme do të nënkuptohet kur subjektet e mbikëqyrjes së Bordit të Mbikëqyrjes Publike kanë shkelur ose janë shmangur nga rregullat, rregulloret dhe standardet profesionale teknike ose etike duke përfshirë edhe të mëposhtmet:
 - a. Kërkesat ligjore të ligjit për auditimin;
 - b. Kërkesa të tjera ligjore që lidhen me ushtrimin e profesionit;
 - c. Kërkesat statutores të BMP-së;
 - ç. Kërkesat e ardhura nga rregulloret, rregullat dhe vendimet e BMP-së;
 - d. Kërkesat statutores të organizatave profesionale të cilat miratohen nga BMP-ja;
 - dh. Kodin e Etikës së Organizatave Profesionale (të cilat duhet të jenë në pajtueshmëri të plotë ose të njëjtë me Kodin e Etikës së Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC));
 - e. Aktivitetet kriminale;
 - ë. Veprimtari apo shkelje të cilat çënojnë integritetin dhe imazhin e profesionit kontabël;
 - f. Një numër rastesh më pak serioze të neglizhencës profesionale që kumulativisht mund të tregojnë paaftësi për të ushtruar të drejtat e ushtrimit të profesionit;
 - g. Punë të pakënaqshme siç janë mangësitë e dukshme të shpalosura në rishikimet që dalin të pasuksesshme përgjatë kontrollit të cilësisë;
 - gj. Mosdhënia e informacionit ose dhënia e informacionit të gabuar nga organizatat profesionale;
 - h. Mosshlyerja e detyrimeve (të cilat çënojnë vijimësinë e veprimtarisë së BMPsë dhe mbrojtjen e interesave të publikut) nga organizatat profesionale në përputhje me kuadrin e zbatueshëm rregullator.

Neni 10

Mënyrat e nisjes procedurës nga BMP

1. Rastet kur do të nisi procesi i investigimit do të jetë sipas qasjeve të mëposhtme:
 - a. **Qasja e bazuar në ankesat:** Investigimi nis si rrjedhojë e marrjes së një ankese nga një subjekt ndaj kujtdo subjekti të mbikëqyrjes publike nga BMP;
 - b. **Qasja e bazuar në informacionin e marrë si rrjedhojë e procesit të kontrollit të cilësisë:** Investigimi i mëtejshëm i rasteve kur rezultatet e kontrollit të cilësisë janë të pakënaqshme;²
 - c. **Qasja e bazuar në informacionin e marrë nga palë të jashtme:** Investigimi nis si rrjedhojë e marrjes së informacionit nga palë të jashtme të cilat vihen në dijeni dhe raportojnë pranë BMP-së për shkelje të mundshme nga subjektet e mbikëqyrjes;
 - ç. **Qasja me kërkesë të BMP-së:** (e miratuar me shumicë të thjeshtë) bazuar në një rast të justifikuar i cili ka natyrë publike ose jo.

² Ndryshuar me Vendim Nr. 65, datë 26.12.2019 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

2. Mbështetur në katër qasjet e mësipërme procedurat e investigimit dhe shqyrtimi i evidencave nisin me autorizim të BMP-së ose të Drejtorit Ekzekutiv.³
Në rastet kur në mbledhjen e tij, KIDB konstaton një rast urgjent bazuar në faktet e paraqitura mund të nisë një procedurë investigimi pa autorizimin e BMP-së ose të Drejtorit Ekzekutiv. Në këtë rast, KIDB duhet të informojë brenda 3 ditëve Kryetarin e BMP-së dhe Drejtorin Ekzekutiv ku së paku njëri prej tyre duhet të japi miratimin.⁴ Raste urgjente konsiderohen ato raste që vijnë nga shkeljet flagrante të ligjit apo rregulloreve të BMP-së.⁵
3. Inspektorët e ngarkuar me këtë përgjegjësi dorëzojnë një raport me evidencat e grumbulluara te BMP-ja.

Neni 11

Marrja e informacionit, depozitimi dhe forma e tij

1. Ankesat e ardhura pranë BMP duhet të jenë në formë të shkruar dhe duhet të përmbajnë të dhëna të rëndësishme për fakte dhe rrethana të ekzistencës së një sjelljeje të keqe apo papajtueshmërie, mbi të cilën mund të gjykohet për kryerjen e nje procesi investigimi.
2. Ankesa duhet të përmbajë minimalisht këto elemente:
 - a. Të dhëna mbi ankuesin, të identifikuar në mënyrë të qartë;
 - b. Të dhëna mbi subjektin e mbikqyrjes objekt i ankesës;
 - c. Përshkrimin e shkeljeve të supozuara apo rrethanave konkrete të pretenduara dhe kohën e ndodhjes së tyre;
 - ç. Dokumentet apo burimet mbështetëse të atyre fakteve apo rrethanave të pretenduara;
3. Gjatë procesit investigativ ankimuesi mund të plotësojë dokumentacionin mbështetës me dokumenta të tjera që ai i gjykon të arsyeshme, si edhe me dokumentacione të tjera që mund t'i kërkohen nga Struktura Mbështetëse në funksion të procesit të investigimit.
4. KIDB dhe struktura mbështetëse që mund të përfshihet në procesin e marrjes së ankesave duhet të ruajë konfidencialitetin e plotë të të dhënave të ankimuesit deri në mbledhjen e evidencave dhe fakteve të cilat janë të domosdoshme për të arritur në një konkluzion.
5. Rastet e përgjithshme kur ankesat vijnë të paidentifikuara nuk do të konsiderohen me përjashtim të atyre rasteve kur natyra e informacionit është e tillë që vihet në rrezik interesi

³ Ndryshuar me Vendim Nr. 65, datë 26.12.2019 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

⁴ Ndryshuar me Vendim Nr. 65, datë 26.12.2019 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

⁵ Ndryshuar me Vendim Nr. 65, datë 26.12.2019 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

publik dhe çënohet mënyra e organizimit dhe veperimtarisë së profesionit. Në këto raste KIDB kërkon informacion shtesë në mënyrë të pavarur nga të gjitha burimet ligjore dhe mbas mbledhjes së fakteve paraprake mund të propozojë nisjen e një procesi investigimi në përputhje me këtë rregullore.

Neni 12

Investigimi mbi bazë ankese

1. Ankesat ndaj subjekteve të mbikqyrjes, regjistrohen pranë Strukturës Mbështetëse (person i autorizuar nga Kryetari i BMP-së).
2. Ankesat e depozituara në BMP, brenda 3 ditëve pune i përcillen për shqyrtim KIDB dhe njëkohësisht informohet Kryetari i BMP-së dhe Drejtori Ekzekutiv.⁶
3. KIDB brenda 10 ditëve pune, nga data e marrjes së njoftimit për ankesën, mblidhet për shqyrtimin e saj.
4. KIDB në mbledhjet e organizuara për shqyrtimin e ankesave merr vendim lidhur me shqyrtimin dhe vlerësimin e rastit për nisjen ose jo të investigimit.⁷
5. Përfundimi i verifikimit të ankesës nga KIDB bëhet jo më vonë se 20 ditë kalendarike nga dita e fillimit të procesit të investigimit. Ky afat mund të shtyhet me aprovim të Kryetarit të BMP-së ose të Drejtorit Ekzekutiv vetëm për shkaqe të arsyeshme dhe të argumentuara.⁸
6. KIDB njofton me shkrim, nëpërmjet Strukturës Mbështetëse, palët e përfshira në proces dhe ato të interesuara kur nis një proces investigativ.

Neni 13

Investigimi bazuar në informacionin e marrë si rrjedhojë e procesit të kontrollit të cilësisë

1. Procedura e investigimit të mëtejshëm për rastet kur rezultatet e kontrollit të cilësisë janë të pakënaqshme bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në manualin për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore.⁹

⁶ Ndryshuar me Vendim Nr. 65, datë 26.12.2019 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

⁷ Ndryshuar me Vendim Nr. 65, datë 26.12.2019 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

⁸ Ndryshuar me Vendim Nr. 65, datë 26.12.2019 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

2. Kontrolli i cilësisë për qëllime të kësaj rregulloreje lidhet me kontrollin e cilësisë së kryer ndaj audituesit ligjor dhe shoqërive të auditimit por edhe me kontrollin e cilësisë së kryer ndaj shoqërive të kontabilistëve të miratuar në përputhje me kuadrin rregullator të miratuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.
3. Koha dhe afatet për nisjen dhe përfundimin e procedurës së investigimit përcaktohen nga Kryetari i BMP-së ose nga Drejtori Ekzekutiv. Ky afat mund të shtyhet me aprovim nga Kryetari i BMP-së ose nga Drejtori Ekzekutiv bazuar në kërkesën e KIDB vetëm për shkaqe të arsyeshme e të argumentuara.¹⁰

Neni 14

Investigimi mbi bazën e informacioneve të tjera - jo ankesë

1. Në rastet kur BMP disponon informacione të marra nga burime të sigurta, që tregojnë për mundësinë e sjelljes së keqe, shkeljeve, apo papajtueshmërisë së subjekteve të mbikëqyrjes, KIDB me kërkesë të Kryetarit të BMP-së, Drejtorit Ekzekutiv ose me iniciativën e vet shqyrton mundësinë e nisjes së procesit të investigimit.¹¹
2. Investigimi mbi bazën e informacioneve – jo ankesë, mund të kryhet si për veprimtarinë e drejtpërdrejtë profesionale ashtu dhe për çështjet që lidhen me zbatimin e detyrimeve të tjera që rrjedhin nga kuadri rregullator/ligjor si subjekt i mbikëqyrjes.
3. Për investigimet mbi bazën e informacioneve – jo ankesë, koha dhe afatet duhet të përcaktohen nga Kryetari i BMP-së ose nga Drejtori Ekzekutiv. Ky afat mund të shtyhet me aprovim të Kryetarit të BMP-së ose Drejtorit Ekzekutiv bazuar në kërkesën e KIDB vetëm për shkaqe të arsyeshme e të argumentuara.¹²

Neni 15

Investigimi me kërkesë të BMP-së

1. Për raste apo çështje të cilat kanë ardhur në vëmendjen e anëtarëve të BMP-së, për të cilat ka dyshime të arsyeshme se ka një shkelje të kuadrit rregullator/ligjor mund të nisë një procedurë investigimi.

⁹ Ndryshuar me Vendim Nr. 65, datë 26.12.2019 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

¹⁰ Ndryshuar me Vendim Nr. 65, datë 26.12.2019 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

¹¹ Ndryshuar me Vendim Nr. 65, datë 26.12.2019 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

¹² Ndryshuar me Vendim Nr. 65, datë 26.12.2019 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

2. Propozimi për përfshirjen në rendin e ditës për vendimmarrje në mbledhjet e BMP-së bëhet sipas dispozitave të parashikuara në statutin e miratuar të BMP-së.
3. Pasi është përfshirë në rendin e ditës dhe është paraqitur për vendimmarrje nisja e procedurës së investigimit (e cila duhet të jetë e bazuar në një rast të justifikuar i cili ka natyrë publike ose jo) BMP autorizon KIDB të nis inspektimin.

Neni 16

Kryerja e investigimit dhe dokumentimi i tij

1. KIDB ka përgjegjësinë e trajtimit të sigurtë dhe konfidencial të dokumentave dhe evidencës që merr nga palët.
2. KIDB gjatë kryerjes së procesit investigativ duhet të testojë nëse sjellja e subjektit të mbikëqyrjes ka dështuar të jetë e njëjtë me atë që do të kishte qënë parashikuar të ishte për rrethanat, në të cilën ka ndodhur apo rrjedhur ngjarjet.
3. Për të përmbushur misionin e tij, KIDB ka të drejtë t'u kërkojë subjekteve të mbikëqyrjes dhe palëve të treta informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për të arritur në konkluzionet e duhura për çështjen që investigohet.
4. Subjektet e mbikëqyrjes duhet të kooperojnë në proceset e investigimit dhe t'u përgjigjen në kohë të arsyeshme të gjitha komunikimeve të bëra nga KIDB. Subjektet e Mbikëqyrjes të cilët nuk bashkëpunojnë apo nuk i përgjigjen në kohë komunikimeve, i nënshtrohen sanksioneve të parashikuara për rastet e mosdhënies së informacionit apo dhënies së informacionit të gabuar.
5. Në përfundim të procesit KIDB dhe vë në dijeni duke adresuar rekomandimet për masat e BMP, bazuar në gjetejet dhe evidencën e dalë nga procesi i investigimit.
6. BMP rishikon të gjithë evidencën dhe faktet e grumbulluara dhe mblidhet për të marrë vendim, i cili duhet të përmbajë dhe mendimin e KIDB nëse ka fakte apo rrethana që mund të çojnë në inicimin e një procesi disiplinor ndaj subjekteve të mbikëqyrjes që janë përfshirë.
7. Propozimi i ardhur nga KIDB duhet të shoqërohet me një relacion përshkrues, i cili duhet të përmbajë:
 - a. Objektin e verifikimit;
 - b. Pretendimet e ngritura nga ana e ankuesit;
 - c. Pretendimet apo arsyetimet e mundshme të subjektit të mbikëqyrjes;

- ç. Referencë të dokumentave, faktet dhe rrethanat që përbëjnë shkelje në referim të ligjit dhe standarteve profesionale;
- d. Përmbledhjen e të dhënave kryesore të rastit të verifikuar;
- dh. Përfundimet nëse ekzistojë në rastin konkret shkelje të ligjit, të standardeve teknike, profesionale dhe të kërkesave etike përfshirë edhe gjithë kuadrin rregullator të zbatueshëm si dhe vlerësimin nëse ato përbëjnë ose jo shkaqe të arsyeshme për marrjen e masave disiplinore;
- e. Propozimin lidhur me trajtimin e mëtejshëm të verifikimit.

Neni 17

E drejta e përfaqësimit

1. Në kryerjen e investigimit KIDB udhëhiqet nga parimi i pjesëmarrjes së subjektit të mbikqyrjes të përfshirë në çështjen që investigohet, nëpërmjet vënies në dijeni, dëgjimit dhe verifikimit të pretendimeve të tij dhe të trajtimit të tij në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë.
2. Kur e gjykon të nevojshme KIDB organizon seanca dëgjimore të palëve të përfshira në procesin investigativ.
3. Përpara propozimit të masave prane BMP, KIDB organizon të paktën një seancë dëgjimore të palëve të përfshira në procesin investigativ.
4. Njoftimi për organizimin e seancës dëgjimore dërgohet me shkrim të paktën 10 ditë përpara organizimit të saj.
5. Palët e përfshira në procesin investigativ kanë të drejtë që gjatë seancave dëgjimore të asistohen dhe/ose të përfaqësohen nga një këshilltar ose nga një avokat. Në rastet e delegimit të të drejtës së përfaqësimit tek persona të tretë, ata duhet të paraqesin një autorizim me shkrim për të drejtën e përfaqësimit. Seancat dëgjimore zhvillohen në prezencë të BMP –së.

Neni 18

Shqyrtimi nga BMP dhe masat disiplinore

1. Në përfundim të një procedure investigimi dhe përpilimit të propozimit KIDB, harton një relacion shpjegues dhe përcakton propozimin për vendimin që duhet marrë.
2. Relacioni së bashku me propozimin për masën që duhet marrë i dërgohen për një opinion ligjor personelit që merret me çështjet ligjore dhe vetëm mbas marrjes së një opinion ligjor ky relacion së bashku me opinionin ligjor i kalon për shqyrtim Bordit të Mbikqyrjes Publike.

3. Në rastet kur natyra e çështjes kërkon njohuri të tilla, të cilat e limitojnë personelin që merret me çështje ligjore për të dhënë një opinion të plotë, personeli për çështjet ligjore mund të kërkojë që çështja të kalojë pranë komisionit për çështjet ligjore duke adresuar edhe nevojën e ekspertëve të jashtëm të cilët mund të jenë të nevojshëm për të mbështetur plotësisht opinionin ligjor.
4. Kur relacioni që shoqëron propozim e KIDB nuk është i plotë dhe mjaftueshmërisht i argumentuar BMP e kthen çështjen për rishqyrtim pranë KIDB dhe përcakton edhe afatet e këtij rishqyrtimi.
5. Në të gjitha ato raste kur opinion ligjor i personelit që merret me çështjet ligjore apo opinionin i komisionit të çështjeve ligjore pranë BMP-së pasqyron një papajtueshmëri midis rekomandimit të KIDB (apo procedurave të kryera për të arritur në këtë konkluzion) dhe kuadrit rregullator/ligjor, atëherë BMP rrëzon rekomandimin duke mos ndërrmarë asnjë masë disiplinore. Nëse BMP gjykon që ka çështje të reja të pa trajtuara nga procesi fillestar i investigimit mund të kërkojë një investigim shtesë duke u siguruar që nuk ka proces ripërsëritjeje të procedurës dhe evidencës së grumbulluar. Në këto raste procedura bëhet në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje duke ndjekur të gjitha hapat e nevojshëm me kushtin që nuk ka përsëritje të procedurës dhe evidencës së grumbulluar.
6. Për të gjitha rastet e investiguara për të cilat BMP ka vendosur të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e mbikqyrjes, dosja e investigimit që përmban rezultatet e verifikimeve, evidencat e përcaktuara në këtë rregullore dhe relacionin e KIDB-së, së bashku me vendimin e BMP-së në të cilin është kategorizuar shkelja, ruhen dhe dokumentohen pranë BMP-së.
7. Në rastet kur KIDB nuk propozon masa disiplinore ose masat disiplinore kanë natyrë rekomanduese relacioni dorëzohet drejtpërdrejt në BMP pa pasur nevojën e një opinionin ligjor. BMP mund të vendosë nëse përpara se të marrë vendim të kërkojë një mendim ligjor ose jo.

Neni 19

Masat administrative dhe disiplinore për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit

1. Masat administrative për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit janë:
 - a. Rekomandim për përmirësim;
 - b. Vërejtje dhe rekomandim për përmirësim pa shënim në regjistrin publik.
2. Masat disiplinore për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit janë:
 - a. vërejtje me shënim në regjistrin publik;
 - b. gjobë;

- c. pezullim i përkohshëm, për një kohë jo më shumë se pesë vite;
 - ç. fshirje e përhershme nga regjistri publik, e cila përmban ndalimin përgjithmonë të ushtrimit të profesionit.
3. Masa administrative e përcaktuar në shkronjën “a” dhe “b”, të pikës 1 të këtij neni, jepet në rastet kur shkelja e konstatuar nuk plotëson kriteret për marrjen e masave disiplinore të parashikuara në shkronjat “a” të pikës 2, të këtij neni, dhe kanë një natyrë rekomanduese ose shmangie e cila mund të përmirësohet pa krijuar shkelje ligjore. Këto masa jepen kur subjekt i mbikëqyrjes ka bërë deklaram vullnetar (përpara nisjes së procesit të investigimit apo kontrollit të cilësisë) dhe/ose kur ka bërë përpjekjet më të mira nëse në mënyrë të arsyeshme ai nuk mund të bënte më shumë për të përmbushur një detyrim të caktuar që vjen si rrjedhojë e kuadrit rregullator. Kostot e procesit të investigimit lidhur me shqyrtimin e këtyre shkeljeve, të parashikuara në këtë pikë të këtij neni, mbulohen nga subjekti i mbikëqyrjes sipas preventivit të llogaritur (mbi evidenca të sakta mbi bazë orare dhe dokumentacioni mbështetës lidhur me kostot e këtij procesi) nga personi përgjegjës për financën pranë BMP-së dhe të miratuara nga Kryetari i BMP-së. Preventivi përpara se të miratohet dërgohet për dijeni të subjektit në mënyrë elektronike i cili mund të sjellë komente lidhur me kostot (brenda 10 ditëve pune nga dërgimi i preventivit të pamiraturar) të cilat mund të gjykohen të pasakta ose të pavërteta. Mbas kalimit të afatit të mësipërm ose ardhjes së komenteve (cilado është më herët) kryetari i BMP miraton preventivin.
 4. Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij neni, jepet në rastet kur shkelja e konstatuar nuk plotëson kriteret e parashikuara në paragrafin më sipër si dhe kriteret për marrjen e masave disiplinore të parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të kësaj pike.
 5. Dënimi me gjobë në masën nga 50.000 – 100.000 lekë jepet në rastet kur audituesi ligjor ka bërë kërkesë për çregjistrim, me arsyen e fillimit të një veprimtarie të re, dhe e ka nisur veprimtarinë e re, që u sjell dëm interesave etikë e moralë të profesionit, përpara marrjes së vendimit nga komiteti i regjistrimit, sipas afateve të parashikuara në rregulloren e miratuar. Vlera e gjobës do të ndërmerret sipas tabelës së niveleve të ndëshkimeve të parashikuar në nenin 21.
 6. Dënimi me gjobë në masën 50.000 – 200.000 lekë jepet në rast se, në përfundim të procesit të kontrollit të cilësisë, rezulton që puna audituese nuk është kryer në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe me kërkesat e ligjit e akteve nënligjore. Vlera e gjobës do të ndërmerret sipas tabelës së niveleve të ndëshkimeve të parashikuar në nenin 21.
 7. Dënimi me gjobë në masën 50.000 – 150.000 lekë jepet në rastin e mosdhënies së informacionit apo dokumentacionit të kërkuar nga autoritetet përgjegjëse, në kuadër të

procesit të kontrollit të cilësisë. Vlera e gjobës do të ndërmerret sipas tabelës së niveleve të ndëshkimeve të parashikuar në nënin 21.

8. Dënimi me gjobë në masën 100.000 – 500.000 lekë jepet në rast të mosndjekjes së rregullave dhe procedurave të auditimit, që kanë sjellë dhënien e një opinioni të mangët ose të gabuar për pasqyrat financiare subjekt auditimi. Vlera e gjobës do të ndërmerret sipas tabelës së niveleve të ndëshkimeve të parashikuar në nënin 21.
9. Dënimi me gjobë në masën 50.000 – 150.000 lekë jepet në rast se nuk respektohen kërkesat e ligjit, për mbrojtjen e konfidencialitetit. Vlera e gjobës do të ndërmerret sipas tabelës së niveleve të ndëshkimeve të parashikuar në nënin 21.
10. Dënimi me gjobë në masën 50.000 – 100.000 lekë jepet në rastin kur informacionet vjetore statutores, të paraqitura pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë, janë të pasakta. Vlera e gjobës do të ndërmerret sipas tabelës së niveleve të ndëshkimeve të parashikuar në nënin 21.
11. Moszbatimi i detyrimeve ligjore nga organizatat profesionale subjekt i mbikëqyrjes së BMP-së përbën një cënim të interesit publik. Në kuadër të mbrojtjes së interesit publik, BMP mbikëqyrë veprimtarinë e organizatave profesionale duke kërkuar informacion të plotë. Në rastet kur organizatat profesionale nuk japin informacionin apo dokumentacionin e kërkuar apo japin informacion të pasaktë bëhet shkak për cënimin e interesit publik dhe ndaj tyre ndërmerren hapat e nevojshëm ligjorë, deri në kallëzim penal.
12. Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 55 të ligjit për auditimin, jepet në rastet kur:
 - a. Ka përsëritje të shkeljes, më shumë se dy herë, të pikave 4, 5, 7 e 8 të nenit 55 të ligjit për auditimin;
 - b. Audituesi ligjor, gjatë funksioneve të tij, kryen edhe funksionin e të punësuarit apo funksione të tjera, që janë në papajtueshmëri me profesionin e audituesit ligjor;
 - c. Marrja përsipër e misionit të auditimit është bërë pa respektuar procedurat e emërimit të tij, të parashikuara nga dispozitat e ligjit, si dhe nga rregullat e auditimit apo nga statuti;
 - ç. Vërtetohet se raporti i auditimit nuk bazohet në dokumentacionin që përmban dosja e auditimit;
 - d. Nga rezultatet e kontrollit të cilësisë rezulton vlerësimi “dobët”;

dh. Ka mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet deklaramit vjetor të kohës, sipas angazhimeve të kryera, dhe kohës në dispozicion të llogaritur, duke mbajtur parasysh bashkëpunëtorët dhe të punësuarit e deklaruar, si dhe mosdeklarimin e bashkëpunëtorëve e të punësuarve.

13. Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën “ç”, të pikës 1, nenit 55 të ligjit për auditimin, jepet në rastet kur:
 - a. Shërbimet e auditimit të pasqyrave financiare bazohen, në një masë të madhe, te rezultatet e rishikimeve periodike të pasqyrave financiare të përmbledhura dhe të auditimit të brendshëm, që janë kryer nga vetë audituesi ligjor apo shoqëria audituese;
 - b. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit përfshihen në shërbime të dhënies së sigurisë për pasqyrat financiare, që përgatiten për qëllime të klientit, kur verifikohet se këto të fundit janë informale dhe të ndryshme nga pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme;
 - c. Shkelja e përcaktuar në pikën 6 dhe shkeljet e përcaktuara në pikën 9, të nenit 55 të ligjit për auditimin, përsëriten më shumë se dy herë.

14. Pezullimi i përkohshëm shoqërohet me ndëshkimin plotësues të moszgjedhjes në organet drejtuese të organizatës profesionale ose në organe të tjera, të parashikuara në këtë ligj. Pezullimi mund të jetë i përgjithshëm ose i kufizuar, në një apo disa kategori shoqërishe e shërbimesh.

15. Për të siguruar barazi në procesin e disiplinës dhe që masat e ndërmarra të jenë në proporcion me nivelin e keqsjelljes, Komisioni i Investigimit Disiplinës së BMP-së duhet të ndjekë të njëjtin parim në propozimin e masave disiplinore. Për këtë arsye, KIDB merr në konsideratë të gjitha rrethanat e rastit duke përfshirë:
 - a. Ndonjë faktor që e thëllon më shumë ose e zvogëlon rastin në fjalë;
 - b. Rrethana personale të individit dhe të ndonjë personi tjetër që mund ta zvogëlojë rrethanat për individin ose shoqëritë p.sh rrethana që i takojnë deri në datën e marrjes së vendimit;
 - c. Ndonjë referencë të siguruar për të mbështetur audituesin ligjor/shoqërinë e auditimit ose njësinë ekonomike.

Neni 20

Masa të tjera disiplinore

1. Ushtrimi i profesionit të audituesit ligjor apo përdorimi i emërtimeve si shoqëri audituese, pa qenë i regjistruar më parë në regjistrin publik të Audituesve ligjorë, si dhe përdorimi i çfarëdo titulli, që synon të krijojë ngjashmëri ose konfuzion me këta tituj profesionalë apo emërtime, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 5.000.000 deri në 10.000.000 lekë.

2. Vendimi për vendosjen e gjobës merret nga BMP.

3. Në të gjitha rastet kur si rrjedhojë e veprimeve direkte ose indirekte të organizatave profesionale vërtetohet apo ka evidenca për shkeljen e kuadrit rregullator në fuqi, duke cënuar interesat e profesionit, BMP thërret asamblenë e përgjithshme të anëtarëve të organizatave profesionale respektive për të komunikuar çështjet në fjalë. BMP në këto mbledhje propozon masat që duhet të ndërmerren nga asambleja e përgjithshme për të rregulluar veprimet e papajtueshme.
4. Vendosja e dënimit administrativ, sipas këtij ligji, nuk ndalon paraqitjen e kallëzimit penal në prokurori.

Neni 21

Ndarja e niveleve të masave disiplinore

1. Në këtë nen zërdhehen masat disiplinore sipas niveleve të shkeljes për shmangien e kryer.
2. Nivelet e shkeljes për qëllime të kësaj rregullore do të jenë si më poshtë:
 - Këshillues
 - I vogël
 - I mesëm
 - I madh
 - I konsiderueshëm
 - Kritik
3. Klasifikimi i shkeljeve do të bëhet si më poshtë:

Tabela 1: Tabela mbi nivelet e ndëshkimeve

Përshkrimi i rastit të shkeljes	Niveli i shkeljes së aplikuar	Masa
Rastet kur audituesi ligjor ka bërë kërkesë për çregjistrim, me arsyen e fillimit të një veprimtarie të re, dhe e ka nisur veprimtarinë e re, që u sjell dëm interesave etike e morale të profesionit, përpara marrjes së vendimit nga komiteti i regjistrimit, sipas afateve të parashikuara në rregulloren e miratuar	I vogël	50,000 LEKË
	I mesëm	60,000 LEKË
	I madh	70,000 LEKË
	I konsiderueshëm	80,000 LEKË
	Kritik	100,000 LEKË

Përshkrimi i rastit të shkeljes	Niveli i shkeljes së aplikuar	Masa
Rastet kur në përfundim të procesit të kontrollit të cilësisë, rezulton që puna audituese nuk është kryer në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe me kërkesat e këtij ligji dhe akteve nënligjore.	I Vogël	50,000 LEKË
	I mesëm	70,000 LEKË
	I madh	110,000 LEKË
	I konsiderueshëm	150,000 LEKË
	Kritik	200,000 LEKË
Rastet e mosdhënies së informacionit apo dokumentacionit të kërkuar nga autoritetet përgjegjëse, në kuadër të procesit të kontrollit të cilësisë.	I Vogël	50,000 LEKË
	I mesëm	65,000 LEKË
	I madh	85,000 LEKË
	I konsiderueshëm	110,000 LEKË
	Kritik	150,000 LEKË
Rastet e mosndjekjes së rregullave dhe procedurave të auditimit, që kanë sjellë dhënien e një opinioni të mangët ose të gabuar për pasqyrat financiare subjekt auditimi.	I Vogël	100,000 LEKË
	I mesëm	200,000 LEKË
	I madh	300,000 LEKË
	I konsiderueshëm	400,000 LEKË
	Kritik	500,000 LEKË
Rastet kur nuk respektohen kërkesat e parashikuara nga neni 34 i ligjit për auditimin për mbrojtjen e konfidencialitetit.	I Vogël	50,000 LEKË
	I mesëm	65,000 LEKË
	I madh	85,000 LEKË
	I konsiderueshëm	110,000 LEKË
	Kritik	150,000 LEKË
Rastet kur informacionet vjetore	I Vogël	50,000 LEKË

Përshkrimi i rastit të shkeljes	Niveli i shkeljes së aplikuar	Masa
statutore, të paraqitura pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë, janë të pasakta.	I mesëm	60,000 LEKË
	I madh	70,000 LEKË
	I konsiderueshëm	80,000 LEKË
	Kritik	100,000 LEKË
Ushtrimi i profesionit të audituesit ligjor apo përdorimi i emërtimeve si shoqëri audituese, pa qenë i regjistruar më parë në regjistrin publik të Audituesve ligjorë, si dhe përdorimi i çfarëdo titulli, që synon të krijojë ngjashmëri ose konfuzion me këta tituj profesionalë apo emërtime, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë.	I Vogël	5,000,000 LEKË
I mesëm	6,000,000 LEKË	
I madh	7,000,000 LEKË	
I konsiderueshëm	8,500,000 LEKË	
Kritik	10,000,000 LEKË	

4. Përcaktimi dhe përshkrimi i nivelit të shkeljeve bëhet në përputhje me nenin 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 22

Heqja e të drejtës për të kryer shërbimin e auditimit ligjor për shoqëritë audituese dhe audituesit ligjorë

1. E drejta për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri audituese hiqet nga bordi, në rastet kur shkelen kushtet dhe/ose kur ndryshojnë rrethanat e parashikuara në ligjin për auditimin, të cilat konsiderohen të domosdoshme për autorizimin e regjistrimit.
2. Bordi, në vend të heqjes së të drejtës për ushtrimin e veprimtarisë, mund të përcaktojë një kohë të arsyeshme, për të rregulluar gjendjen e pjesëmarrjes në kapital apo të pjesëmarrjes në organet drejtuese. Nëse edhe pas kalimit të afatit të përcaktuar nga bordi, gjendja nuk është

rregulluar, bordi vendos heqjen e së drejtës për ushtrimin e profesionit dhe çregjistrimin nga regjistri publik.

3. E drejta për ushtrimin e profesionit të një audituesi ligjor apo të një shoqërie audituese, mund të hiqet, nëse reputacioni është dëmtuar ndjeshëm. Bordi, në vend të heqjes së të drejtës për ushtrimin e profesionit, mund të vendosë pezullimin e ushtrimit të profesionit, duke vënë në dispozicion një periudhë kohe të arsyeshme, e cila është e barabartë me pezullimin, një listë të kërkesave që duhen plotësuar, për të siguruar kthimin e reputacionit të mirë. Nëse edhe pas kalimit të afatit të përcaktuar nga bordi kërkesat nuk janë plotësuar, bordi vendos heqjen e së drejtës për ushtrimin e profesionit dhe çregjistrimin nga regjistri publik.
4. Mospërmbushja e detyrimeve të kualifikimit të vijueshëm në përputhe me kërkesat ligjore dhe rregulloret për edukimin e vijueshëm dhe praktikën profesionale të miratuar nga BMP-ja është kusht për mosregjistrimin e audituesve ligjorë në listën e publikueshme për të gjithë vitin pasardhës.

Neni 23

Raste të tjera disiplinore për çregjistrimin e audituesve ligjorë nga regjistri publik

1. Audituesi ligjor fshihet përfundimisht nga regjistri publik i audituesve ligjorë në rastet kur:
 - a. konstatohen parregullsi në: i. dokumentet e nevojshme, të lidhura me provimet e aftësisë profesionale; ii. deklaratimet, të cilat rezultojnë të pavërteta, në lidhje me dhënien fund të papajtueshmërive, që kërkohen për ushtrimin e profesionit në praktikë dhe për garancitë etike e morale, të dorëzuara në çastin e bërjes së kërkesës për regjistrimin e parë në regjistrin publik; iii. dokumentet e në faktet e deklaruara gjatë procedurave të mundshme të pezullimit të përkohshëm të ushtrimit të profesionit;
 - b. në përfundim të një procedure disiplinore ndaj tij, është marrë masa disiplinore e çregjistrimit nga regjistri publik;
 - c. për shkak të shkeljeve dhe masave disiplinore të përsëritura, reputacioni i të regjistruarit është cenuar ndjeshëm;
2. Fshirja përfundimtare nga regjistri publik bëhet me vendim të BMP pasi janë ndjekur të gjitha hapat e nevojshëm të investigimit dhe verifikimit të fakteve dhe evidencës lidhur me rastin. Nëse evidenca e shqyrtuar është e pa mjaftueshme ose e pa plotë BMP hedh poshtë rastin duke lejuar regjistrimin në regjistrin publik në përputhje me kuadrin rregullator të miratuar nga BMP-ja

Neni 24

Masat administrative dhe disiplinore ndaj kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilistëve të miratuar

1. Për rregullimin e profesionit të kontabilistit të miratuar dhe organizatave profesionale të kontabilitetit, për anëtarët e organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit do të zbatohen masat e mëposhtme:
 - a. Rekomandim për përmirësim;
 - b. Vërejtje dhe rekomandim për përmirësim të Kontabilistëve të Miratuar pa shënim në regjistrin publik të organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit;
 - c. Vërejtje për Kontabilistët e Miratuar me shënim në regjistrin publik të organizatave në fushën e kontabilitetit;
 - ç. Pezullim të përkohshëm të Kontabilistëve të Miratuar, për një kohë jo më shumë se pesë vite;
 - d. Fshirje e përhershme e Kontabilistëve të Miratuar nga të gjithë regjistrat publikë të organizatave profesionale, e cila përmban ndalimin përgjithmonë të ushtrimit të profesionit.
2. Masa administrative e përcaktuar në shkronjën “a” dhe “b”, të pikës 1, jepet në rastet kur shkelja e konstatuar nuk plotëson kriteret për marrjen e masave disiplinore të parashikuara në shkronjat “c” të pikës 1, të këtij neni, dhe kanë një natyrë rekomanduese ose shmangie e cila mund të përmirësohet pa krijuar shkelje ligjore.
3. Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij neni, jepet në rastet kur shkelja e konstatuar nuk plotëson kriteret për marrjen e masave disiplinore të parashikuara në shkronjat “ç”, “d” të kësaj pike. Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën “c” jepet për rastet në vijim:
 - a. Rastin e mosdhënies së informacionit apo dokumentacionit të kërkuar nga autoritetet përgjegjëse, në kuadër të procesit që mund të lidhet me kontrollet e cilësisë të ndërmarra nga BMP-ja;
 - b. Kur ka mungesë të një kontrate në të cilën detajohen termat e angazhimit dhe përgjegjësit e palëve;
 - c. Kur ka shkelje të kodit të etikës Kodin e Etikës së Organizatave Profesionale (të cilat duhet të jenë në pajtueshmëri të plotë ose të njëjtë me Kodin e Etikës Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC)).
4. Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, jepet në rastet kur:
 - a. Ka përsëritje të shkeljes, më shumë se dy herë, të rasteve të parashikuara në pikën 3 të këtij neni;

- b. Kontabilisti i miratuar apo shoqëria e kontabilitetit, gjatë funksioneve të veta, kryen edhe funksionin e auditimit ligjor (të dokumentuar përmes raporteve apo kontratave të angazhimit apo evidencave të tjera që provojnë kryerjen e shërbimit). Përveç sanksioneve të parashikuara në këtë pikë për pezullimin e licencës zbatohen dhe masat ndëshkimore të parashikuara në nenin 20 pika 1, të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 58 të ligjit për auditimin;
 - c. Ka mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet deklaramit vjetor të kohës, sipas angazhimeve të kryera, dhe kohës në dispozicion të llogaritur, duke mbajtur parasysh bashkëpunëtorët dhe të punësuarit e deklaruar.
5. Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën “d”, të pikës 1, të këtij neni, jepet në rastet kur:
- a. kontabilistët e miratuar dhe shoqëritë e kontabilistëve të miratuar përfshihen në shërbime të hartimit të pasqyrat financiare qëllimisht të deformuara duke mbajtur paralelisht dy lloje kontabiliteti me qëllimin për manipulimin e qëllimshëm të pasqyrave financiare. Nuk përbëjnë deformim të qëllimshëm rastet kur pasqyrat mbahen sipas disa kuadrove të ndryshëm të raportimit (SNRF, SKK, Kuadri Raportimit të Grupit apo ndonjë kuadri raportimi të brendshëm të organizatës/entitetit) apo për qëllime të lidhura me kontabilitetin e kostos dhe atë menaxherial, apo hartimi i pasqyrave apo raporteve të ndërmjetme të cilat janë vetëm për qëllime të brendshme ose të grupit.
 - b. Shkeljet e përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, përsëriten më shumë se dy herë.
6. Për të siguruar barazi në procesin e disiplinës dhe që masat e ndërmarra të jenë në proporcion me nivelin e keqsjelljes, KIDB dhe KIDO përkatëse (për KM) duhet të ndjekin një parim në vendosjen e masave disiplinore. Për këtë arsye, merren në konsideratë të gjitha rrethanat e rastit duke përfshirë:
- a. Ndonjë faktor që e thellon më shumë ose e zvogëlon rastin në fjalë;
 - b. Rrethana personale të individit dhe të ndonjë personi tjetër që mund ta zvogëlojë rrethanat për individin ose shoqëritë p.sh rrethana që i takojnë deri në datën e marrjes së vendimit;
 - c. Ndonjë referencë të siguruar për të mbështetur audituesin ligjor/shoqërinë e auditimit ose njësinë ekonomike.
7. Mospërmbushja e detyrimeve të kualifikimit të vijueshëm në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloren për edukimin e vijueshëm dhe praktikën profesionale të miratuara nga BMP-ja është kusht për mosregjistrimin e kontabilistëve të miratuar në listën e publikueshme të kontabilistëve të miratuar në përputhje me rregullat dhe aktet e miratuara nga BMP për kualifikimin e vijueshëm profesional.
8. Në rastet kur ndaj një KM është marrë një masë ndëshkimore, KM nuk mund të regjistrohet në asnjë organizatë tjetër profesionale pa u shlyer ndëshkimi.

Neni 25
Afatet për shlyerjen e gjobës

1. Në rastin e masës disiplinore me gjobë, audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit, apo subjektet e tjera të mbikëqyrjes ndaj të cilave është marrë masë disiplinore duhet të shlyejë, brenda 2 muajve, masën e gjobës. Në të kundërt, zbatohet masa disiplinore e pezullimit të përkohshëm, deri në çastin e shlyerjes së saj.
2. Për vonimin e pagesës së gjobave aplikohen masat e parashikuara në rregulloren e të ardhurave të miratuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike

Neni 26
Evidencat dhe dokumentimi i tyre

1. Për qëllime të marrjes së masave disiplinore ose jo do të përdoren vetëm ato që quhen evidenca që ligjërisht pranohen në gjykatë që për qëllim të kësaj rregulloreje do të bëhet një përkufizim dhe përcaktim i përgjithshëm pa u limituar vetëm në to.
2. Për qëllime të kësaj rregulloreje këto evidenca do të quhen evidenca zyrtare.
3. Për qëllime të investigimit dhe hapjes së një çështje investigimi KIDB/KIDO mund të përdori edhe evidenca të cilat jo domozdoshmërisht përbëjnë një fakt ligjor megjithatë informacioni i siguruar prej tyre përben një evidencë të qënësishme e cila mund të coj në zbulimin e evidencave që ligjërisht mund të pranohen edhe nga gjykata të cilat deshmojnë shkelje apo papajtueshmëri ligjore.
4. Në listën e evidencave zyrtare do të përfshihen, por pa u limituar vetëm në to:
 - a. Raportet e nënshkruara dhe vulosura zyrtarisht nga subjektet e mbikëqyrjes të cilat janë të publikuara zyrtarisht, me kushtin që të mos jenë të fallsifikuara apo të krijuara në keqpërdorim. Në këto raste nëse subjekti i mbikëqyrjes vihet në dijeni duhet të ngrejë një ankimim pranë BMP për keqpërdorim apo fallsifikim. BMP-ja udhëzon si të procedohet më tej me to nesë natyra e këtyre evidencave është materiale;
 - b. Intervistat të cilat janë të regjistruara me aprovim të subjektit apo të cilat dokumentohen përmes një procesverbali i cili nënshkruhet nga subjekti;
 - c. Komunikimi përmes postës elektronike me kushtin që adresa e emailit është e autorizuar dhe është nënshkruar prej subjektit që kjo adresë shërben edhe si evidencë zyrtare. Në rast të ndryshimit të adresës elektronike subjekti duhet të vërë në dijeni organizatën profesionale apo/dhe BMP-në sipas rasteve;

- ç. Çdo dokumentacion zyrtar i cili përpilohet dhe dorëzohet nga subjekti i mbikëqyrur (p.sh faturë, pasqyra financiare, etj);
- d. Evidenca statistikore të cilat përdoren nga inspektorët për të krahasuar të dhënat faktike me ato të lejuara;
- dh. Të tjera evidenca të pranuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 27

Dhënia e udhëzimeve për subjektet e mbikëqyrjes, lidhur me zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje

1. Çdo subjekt i parashikuar në këtë rregullore por edhe palë të tjera të cilat janë të lidhura apo kanë hyrë në marrëdhënie me subjektet e mbikëqyrura për qëllime të kësaj rregulloreje mund t'i kërkojnë BMP-së të japë udhëzime për zbatimin e dispozitave, të cilat mund të jenë të paqarta përgjatë leximit prej tyre.
2. Bordi i Mbikëqyrjes Publike udhëzimet mund t'i nxjerrë të veçanta drejtuar drejtpërdrejt palës së interesuar, por edhe të përgjithshme duke e ilustruar me shembuj mbi mënyrën sesi do të zbatohet.
3. Për çështje të caktuara Bordi i Mbikëqyrjes Publike mund t'ia delegojë adresimin e çështjeve apo kërkimin e një rekomandimi KIDB dhe Komisionit apo personit që merret me çështjet ligjore.

Neni 28

Rregullat mbi mënyrën e hartimit dhe dorëzimit të propozimeve

1. Këshilli i drejtimit të organizatave profesionale i propozon Bordit të Mbikëqyrjes Publike me kërkesë të Bordit propozime lidhur me procedurat apo rregulla apo ndryshimin e tyre apo çështje të tjera të lidhura me investigimin dhe masat disiplinore dhe funksionimin e KIDO-ve përkatëse në përputhje me ligjin për auditimin. Këto propozime duhet të jenë të argumentuara në një relacion ose raport shoqërues lidhur me propozimet e kërkuara.
2. Bordi i Mbikëqyrjes Publike në funksion të procesit të mbikëqyrjes dhe rregullatorit mund t'i marrë në shqyrtim këto propozime ose mund të kërkojë propozime të reja duke vendosur referenca apo kërkesa specifike apo rekomandime mbi të cilat duhet të vijnë këto propozime. Referencat, kërkesat specifike apo rekomandimet e Bordit të Mbikëqyrjes Publike duhet të reflektohen plotësisht në propozimet e rishikuara. Në rast se propozimet nuk janë reflektuar BMP i reflekton automatikisht duke bërë miratimin përfundimtar si dhe i tërhiqet vërejtje Këshillit të Drejtimit të Organizatës Profesionale përkatëse. Propozimet e ardhura nga organizatat profesionale duhet të konsultohen përgjatë procesit paraprakisht me Komisionin e

Investigimit dhe Disiplinës të BMP-së përpara se ato të dorëzohen te Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

3. Përpara se të përgatiten zyrtarisht propozimet, Këshilli i Drejtimit të organizatave profesionale duhet të ngrejë një grup profesionistësh të cilët përmbushin të gjitha kualifikimet dhe eksperiencën profesionale në përputhje me ligjin dhe kuadrin rregullator në fuqi për të asistuar në hartimin e këtyre propozimeve.

Neni 29

Administrimi i Procesit të Disiplinës

1. Për secilin rast të investiguar mbahet një dosje sipas një modeli të caktuar nga KIDB dhe menaxhohet nga Struktura Mbështetëse e BMP e cila përmban të gjithë dokumentet përkatëse që kanë lidhje me rastin. Kjo dosje përmban detyrimisht të gjithë dokumentacionin e administruar gjatë procesit investigues që nga fillimi i tij deri në përfundimin e procesit.
2. Për secilën mbledhje të KIDB mbi raste e disiplinës mbahet një procesverbal, ku pasqyrohen data, vendi, rendi i ditës, anëtarët pjesëmarrës në mbledhje, drejtuesi i saj, çështjet që janë diskutuar, forma dhe rezultati i votimeve. Në fund të mbledhjes, procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm.
3. Dosjet duhet të ruhet për një periudhe prej dhjetë vitesh.
4. Struktura Mbështetëse është përgjegjëse për marrjen në kohë të të gjitha masave për asistimin e KIDO në çështjet administrative, sekretariale dhe logjistike.
5. Dispozitat e parashikuara për KIDB në pikën 1 paragrafi i dytë, pikën 2 dhe pikën 3 të këtij nëni zbatohen edhe për KIDO.

Neni 30

Ruajtja dhe asgjësimi i dokumentacionit lidhur me procesin e investigimit dhe disiplinës

1. Dokumentet zyrtare që përgatiten lidhur me procesin e investigimit dhe disiplinës dorëzohen dhe ruhen në fund të çdo procesi në arkivën e BMP-së në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të informacioneve konfidenciale, të cilat ruhen jo më shumë se 1 vit nga data e vendimit përfundimtar.
2. Asgjësimi i tyre bëhet nga një komision prej 3 (tre) anëtarësh, 1 i caktuar nga struktura mbështetëse dhe 2 nga anëtarët e KIDB-së. Deri në asgjësimin e tyre, informacioni konfidencial ruhet në kasafortë ose në një raft të mbyllur metalik me çelës pranë BMP-së.

Neni 31

Publikimi i masave disiplinore

1. Masat disiplinore të marra duhet të publikohen në faqen e internetit të BMP vetëm me autorizim të tij.
2. Me vendim të BMP mund të publikohen raportet e çështjeve të investiguara, pa përmendur emrat e palëve të përfshira, për rastet që ndihmojnë në zbatimin praktik të standardeve, rregullave dhe kodit të etikës, dhe identifikojnë kurthet që duhen shmangur.
3. KIDB mund t'i propozojë BMP që të rekomandojë përmes vendimeve të veçanta përfshirjen në programin e kualifikimit të vazhdueshëm të anëtarëve të organizatave profesionale çështjet apo rastet e investiguara me qëllim që të informojë dhe ndërgjegjësojë të gjithë anëtarët e organizatave profesionale në lidhje me:
 - a. Zbatimin e dispozitave të Kodit të Etikës dhe të rregullave e standardeve profesionale të zbatueshme, si edhe të kërkesave që burojnë nga detyrimet e anëtarësisë në IFAC, dhe;
 - b. Pasojat e mospajtueshmërisë me këto kërkesa.

Neni 32

E drejta e ankimit

1. KIDO përfqëson organizatat profesionale në mbledhjet e BMP-së dhe KIDB kur shqyrtohen rastet e propozuara prej organizatave profesionale për marrje masash disiplinore.
2. Subjektet e mbikëqyrjes kanë të drejtën e ankimit të drejtpërdrejtë pranë BMP-së përkundër të gjitha vendimeve të rekomanduara nga KIDO e organizatave profesionale ndaj tyre.
3. Gjithashtu subjektet e mbikëqyrjes kanë të drejtën e ankimit pranë BMP-së edhe për rekomandimet e dhëna nga KIDB.
4. Bordi i Mbikëqyrjes Publike në të gjitha rastet e ankimeve që bëhen pranë tij adreson çështjen së bashku me dokumentacionin dhe evidencën e mbledhur pranë komisionit apo personit që merret me çështjet ligjore, të ngritur pranë tij, për të parë pajtueshmërinë e rekomandimit/vendimit në raport me pretendimin e palës ankimuese.
5. Kundër vendimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit, dhe të gjitha subjektet e tjera të mbikëqyrjes ndaj të cilës janë zbatuar masa ndëshkimore mund të bëjë ankim në gjykatën administrative kompetente, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

Neni 33
Dispozita përfundimtare

1. Të gjitha rregulloret dhe aktet e nxjerra nga BMP-ja përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, të cilat bien ndesh me dispozitat e reja ligjore, këtë rregullore ose me kuadrin rregullator të miratuar nga BMP-ja, shfuqizohen.
2. Të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë rregullore të cilat nuk janë parashikuar as në rregulloret e tjera do të rregullohen me vendime të veçanta të BMP-së si dhe nga legjislacioni në fuqi.
3. Ngarkohen të zbatojnë këtë rregullore Bordi i Mbikëqyrjes Publike, KIDB, Organizatat Profesionale dhe KIDO-të përkatëse, audituesit dhe shoqëritë e auditimit, kontabilistët dhe shoqëritë e kontabilitetit.

Kryetar

Dritan FINO